



Pranimar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivered	05-12-2022	viti god year	
Organ /Bjësia Organ /Jedinka Org /Unit	Nr. Prot Br. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMSHAK	7685/2022		1/3



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.856/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, në çështjen ankimore me numër A.nr.856/2022 të datës 04.10.2022, të parashtruar nga ankueset

me adresë banimi:

me adresë banimi:

kundër organit të punësimit Zyra e Kryeministrit, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datën 05.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.856/2022 të datës 04.10.2022, të parashtruar nga ankueset dhe

A r s y e t i m

Ankueset dhe me datë 04.10.2022 kanë parashtruar ankesë me numër protokollit 5873/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.856/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimin ankimor për realizimin e të drejtës në kompensim material sipas Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës nr.04/20 të datës 20.12.2017 për periudhën kohore nga publikimi i Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese me rastin nr. KO219/19 të data 09.07.2020 me të cilin ka vlerësuar kushtetutshmërinë e Ligjit nr.06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, më datë 10.10.2022, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Zyra e Kryeministrit, ndërsa me datë 14.10.2022 ka pranua në përgjigjen në ankesë se bashku se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, me datë 15.11.2022 Kryetari i Këshillit ka nxjerrë Vendimin me shifër VK.nr.153/2022 për mes të cilit vendim ankesës A.nr.856/2022 të datës 04.10.2022 ia ka vazhduar afatin vendimmarrës edhe për dhjetë (10) ditë punë.

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesja [redacted] në bazë të Kontratës së Marrëdhënies së Punës Nr.prot.1201/2018 të datës 28.12.2018 dhe Akt emërimit me Nr.prot.235/2020 të datës 12.10.2020 ka qenë e punësuar në pozitën e punës *Zyrtare e Lartë Ligjore* pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, mirëpo e njëjta me datën 19.10.2021 ka dhënë dorëheqje nga marrëdhënia e punës dhe si rrjedhojë me Vendimin me Nr.prot.160/2021 të datës 20.10.2021 të organit të punësimit ankueses i është aprovuar dorëheqja dhe është liruar nga Shërbimi Civil. Ndërsa ankuesja tjetër [redacted] në bazë të Kontratës së Marrëdhënies së Punës Nr.prot.1197/18 të datës 27.12.2018 dhe Akt emërimit me Nr.prot.234/2020 të datës 12.10.2020 ka qenë e punësuar në pozitën e punës *Zyrtare e Lartë Ligjore* po ashtu pranë Zyrës së Kryeministrit të Republikës së Kosovës, mirëpo e njëjta me datë 13.09.2021 ka dhënë dorëheqje nga marrëdhënia e punës dhe si rrjedhojë me Vendimin me Nr.prot.134/2021 të datës 14.09.2021 ankueses i është aprovuar dorëheqja dhe është liruar nga Shërbimi Civil.

Andaj, duke marr parasysh faktin se ankueset nga data 20.10.2020, respektivisht 14.09.2021 kanë humbur statusin e nëpunësit civil, dhe me rastin e parashtrimit të ankesës përveç vendimeve për lirim nga Shërbimi Civil nuk kanë ofruar asnjë prove tjetër ku do të mund të vërtetohej se te njëjtat aktualisht e kanë statusin e nëpunësit civil, Kolegji i Këshillit konstaton se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur për ankesën me numër A.nr.856/2022 të datës 04.10.2022, të parashtruar nga ankueset dhe [redacted] sipas dispozitave të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil.

Ankuesit udhëzohen për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatë të rregullt, gjegjësisht Gjykatën Themelore në Prishtinë/Divizioni Civil, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore.

Për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.



Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër **A.nr.856/2022**

Flakron GASHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Ankueseve
- Sekretarit të Përgjithshme në Zyrën e Kryeministrit;
- Udhëheqësit të Personelit në Zyrën e Kryeministrit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;

